



## KOMUNIKATË PËR SHTYP

Nr.2/2022

Hagë, 18/05/2022

### Trupi Gjykses shqipton Aktgjykimin në çështjen Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj

Sot Trupi Gjykses II I Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) shqiptoi Aktgjykimin në çështjen gjyqësore *Prokurori I Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt*.

Trupi Gjykses I shpalli z. Gucati dhe z. Haradinaj fajtorë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, frikësim gjatë procedurës penale dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës. Këto janë shkelje të Kodit Penal të Kosovës (KPK) dhe Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji). Trupi Gjykses i shpalli të akuzuarit të pafajshëm lidhur me hakmarrjen. Trupi Gjykses dënoi secilin prej të akuzuarve me burgim katër vjet e gjysmë, duke llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim dhe me gjobë 100 euro.

Gjatë shqiptimit të Aktgjykimit, Trupi Gjykses theksoi se kjo çështje ka të bëjë me administrimin e duhur të drejtësisë, integritetin dhe sigurinë e proceseve gjyqësore dhe sigurinë, mirëqenien dhe çlirimin nga frika të qindra personave, të cilët janë paraqitur për të përmbushur detyrën e tyre qytetare si dëshmitarë. Mbrojtja e dëshmitarëve nga frikësimi dhe dëmtimi qëndron në themelin e çdo sistemi të drejtësisë penale, qoftë ai vendor apo ndërkombëtar. Trupi Gjykses i përshkroi veprimet e të akuzuarve si sfida ndaj atij themeli dhe për rrjedhojë si kërcënim për drejtësinë.

Trupi Gjykses konstatoi se në shtator 2020, z. Gucati dhe z. Haradinaj, në tri konferenca për shtyp, në më shumë se njëzetë paraqitje në media të tjera dhe përmes postimeve në mediat sociale zbuluan informacion konfidencial të hetimeve dhe punës së brendshme të Task Forcës Hetimore Speciale (TFHS) dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS). Ky ishte informacion i mbrojtur me ligj që përmbante emrat e qindra dëshmitarëve dhe dëshmitarëve të mundshëm të akuzuarit e zbuluan këtë informacion duke treguar dokumentet që e përmbanin atë informacion, duke i lejuar të tjerët të këqyrnin, filmonin, fotografonin kopjonin ose merrnin me vete dokumentet dhe duke përshkruar publikisht përmbajtjen e dokumenteve. Krahas këtyre veprimeve, Trupi Gjykses konstatoi se të akuzuarit publikisht i quajtën dëshmitarët “tradhtarë”, “spiunë”, “bashkëpunëtorë” dhe “shqipfolsa”. Të bëra në kontekstin e një atmosfere të vazhdueshme të frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë, Trupi Gjykses konstatoi se synimi i komenteve të të akuzuarve ishte për t’i frikësuar dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm dhe rrjedhimisht për t’i bërë që të ngurronin të jepnin informacion për hetimet e ZPS-së lidhur me ish-anëtarë të UÇK-në.

Trupi Gjykses gjithashtu konstatoi se “[s]jellja e të akuzuarve ishte mjeti që shërbente për një qëllim: për të penguar hetimet dhe ndjekjet penale të efektshme të ish-anëtarëve të UÇK-së nga ZPS-ja.

1





## KOMUNIKATË PËR SHYTP

Nr.2/2022

Hagë, 18/05/2022

Lidhur me akuzën e hakmarrjes, Trupi Gjykses konstatoi se sipas përkufizimit të kësaj veprë penale në KPK, ZPS-ja ka detyrimin të vërtetojë se të akuzuarit ishin të vetëdijshëm se informacioni i dhënë prej dëshmitarëve kishte të paktën deri në një farë mase vërtetësi. Trupi Gjykses konstatoi se ZPS-ja nuk kishte arritur të paraqiste prova lidhur me këtë pikë juridike dhe për këtë arsye i shpalli të akuzuarit të pafajshëm për veprën penale të hakmarrjes.

Përmbledhja më e detajuar e Aktgjykimit gjendet në faqen e DHSK-së në internet.

MEDIA

